
Njoftim!

Qeveria Shqiptare me anë të VKM-së nr.nr. 584, datë 08.10.2021 “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike”, mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 90 të ligjit nr.43/2015 “Për

Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ka vendosur mes të tjerave :

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.
2. Ngritjen e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, që drejtohet nga Zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrin e Financave dhe Ekonomisë dhe çdo përfaqësues nga institucione të tjera, që vlerësohen të nevojshëm nga Zëvendëskryeministri.
3. Shoqëritë “KESH”, sh.a., “OST”, sh.a., dhe “OSHEE Group”, sh.a., të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Këto shoqëri të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.
4. Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë që të sigurojë mekanizmat e duhur financiarë, me qëllim mundësimin e importit të energjisë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike.
5. Gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike i shtrin efektet deri më 15 prill 2022.
6. Ngarkohen Zëvendëskryeministri, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Financave dhe Ekonomisë, “KESH”, sh.a., “OST”, sh.a., dhe “OSHEE Group”, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

-
- **Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar në nenin 90 pika 4, ka parashikuar se:**

Të licencuarit nuk janë përgjegjës për sanksionet e ardhura si rezultat i ndërprerjes ose kufizimit të energjisë elektrike, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur situata e emergjencës vjen si rezultat direkt i fajit të të licencuarit.

